V E N D I M
Nr. 126, datë 24.2.1998

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.516, DATË 24.11.1997 "PËR NDRYSHIMIN E ÇMIMIT TË NËNPRODUKTEVE TË NAFTËS DHE TË DIFERENCAVE TË ÇMIMIT TË KARBURANTEVE TË IMPORTIT

Me propozimin e Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 516, datë 24.11.1997 "Për ndryshimin e çmimit të nënprodukteve të naftës dhe të diferencave të çmimit të karburanteve të importit", në pikën 1, pas paragrafit të tretë, shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

"Për gazoilin dhe benzinën e prodhuar në vend çmimet minimale të shitjes me pakicë nuk mund të jenë më të ulëta se 15 lekë për litër nën çmimin maksimal të përcaktuar në paragrafin e parë".

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINSTRI
Fatos Nano